



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 6221 Prot.

Tiranë, më 19.07. 2018

Nr. Identifikimi 526

Vendimi 33

### DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

#### VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Emri i Subjektit:** “ALFLO” sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** L71806040K

**Adresa e selisë:** Rruga “Nikolla Tupe”, pallati nr.4, Ap.3, Shk.1, Njesia Bashkiake nr.5, Tirane

**Personi përgjegjës:** Sofo Limaj

Për të zhvilluar projektin: **“Shfrytëzim me karrierë i gëlqerorëve të mermerizuar, objekti Qafë Shtamë”**

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** “Qafë Shtamë”, Njesia Administrative Koms, Bashkia Mat, qarku Dibër

**Sipërfaqja totale:** 0.173 km<sup>2</sup>

**Lloji Mineralit:** Gëlqeror i mermerizuar.

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”; ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:



**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:  
Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehën:**

- Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat. Gjithashtu, rekomandojmë përgatitjen e një relacioni për mënyrën e shfrytëzimit të mineralit dhe përcaktimin e sipërfaqes së vërtetë që impaktohet nga shfrytëzimi me qëllim reduktimin e sipërfaqes që hiqet nga fondi pyjor.
- Në raportin e thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së sa i takon menaxhimin të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Sugjerojmë të reflektohen në raport të gjitha komentet e dhëna.
- Sugjerojmë të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
- Subjektit t'i vendoset kusht që t'i përmbahet kërkesave të ligjit nr. 10266 datë 15.04.2010 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i cili amendon ligjin nr. 8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” dhe VKM-së nr.435 datë 12.09.2015 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, subjekti duhet të hartojë një plan masash paraprake për të ulur shkarkimet në ajër.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimin të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimin të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura:** Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti shtrihet 900 m larg Parkut Kombëtar “Qaf- Shtamë”. Subjektitë mos përdorë si rrugë kalimi Parkun Kombëtar.

**2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

**Konsultimi me publikun:** Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

### 3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Shkresën e Njoftimit Fitues nga MIE me Nr. 544/2 Prot. datë: 16.11.2017, për zonën minerare konkurruese Nr. 231/7 objekti “Qaf Shtamë”, Qarku Dibër
- “Planin e veprimit për veprimtaritë minerare ndërtimore”, sipas Urdhërit të përbashkët Nr. 67, datë: 11.03.2018, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

### 4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2 Subjekti të mos përdorë në asnjë mënyrë si rrugë kalimi Parkun Kombëtar “Qafë Shtamë”.
- 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.4 Kjo deklaratë është e vlefshme pas miratimit nga MIE për Lejen e Shfrytëzimit.
- 4.5 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.

### Gjatë fazës së instalimit:

- 4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore
- 4.7 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.15 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend

